

**PKR.nr.424/14**

## **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA** si gjykatë e shkallës së parë penale, kryetarja e trupit gjykues, gjyqtarja Suzana Çerkini me sekretaren juridike Ardita Azemi, në çështjen penale kundër të pandehurit S. K. nga fshati P. Komuna F.K., për shkak të veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda PP/nr.636/2013 të datës 05.08.2014, pas shqyrtimit fillestar, të hapur për publikun, të mbajtur më datë 03.08.2016, me praninë e të pandehurit S.K., me mbrojtësin e caktuar sipas detyrës zyrtare av. E. Sh. dhe të Prokurorit të shtetit Feti Tunizliu, të njëjtën ditë, mori dhe shpalli këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**I pandehuri S.K.**, i biri i M. dhe nënës E., e vajzërisë B., i lindur me *data e lindjes...*, në fshatin B. i M. Komuna F.K., tani me vendbanim në fshatin P. Komuna F. K., ka të kryer shkollën e mesme, me profesion polic në Policinë e Kosovës nga viti 2000, i martuar babë i pesë fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar me letërnjoftim RKS me nr. personal *numër personal...*,

### **ËSHTË FAJTOR**

**Sepse**, me datë 05.06.2013 rreth orës 19:00, në lagjen “Dardania”, afër Bashkësisë së Tretë Lokale në Prishtinë, në katin e shtatë, i pandehuri (i cili ishte person zyrtar-polic) derisa ishte jashtë detyrës zyrtare, pas një fjalosjeje me viktimën A. Ll., kishte futë fishekë në tytë dhe duke e kanosur me fjalët “tash ua q... nënën juve”, ia kishte drejtuar viktimës revolen zyrtare të tipit Glock-19, të cilën e ka poseduar me leje valide e cila i është konfiskuar nga ana e policisë,  
- me këtë ka kryer veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK,

Andaj, gjykata, në bazë të nenit 7, 17, 21, 41,42, 46, 49,50,51,52,53,73 të KPRK dhe nenit 248, 365 dhe 366 të KPP, i shqipton,

**DËNIM ME BURGIM ME KUSHT DHE ME GJOBË**

Në kohëzgjatje prej **1 (një) vit e 3 (tre) muaj**, i cili nuk do të ekzekutohet, nëse brenda afatit prej **2 (dy) vjetësh** nuk do të kryejë vepër të re penale, dhe

Në shumë prej **300 € (treqind) euro**, të cilën gjobë obligohet t'a paguajë brenda afatit prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë,

Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën e shqiptuar, gjykata do t'ia zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim, ashtu që një ditë burgimi llogaritet me 20 euro (njëzet) gjobë, dhe

I pandehuri obligohet t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale aq sa do të bëhen sipas llogarisë së gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor do të paguajë shumën prej 40 € (katërdhjetë euro), në afat prej 15 ditësh, pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë,

Të dëmtuarit A.Ll. dhe A. Ll., me shënime personale si në shkresa të lëndës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko-civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, me Aktakuzën PP.I.nr.636/2013 të datës 05.08.2014, ka akuzuar S.K. për vepër penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK dhe, njëherësh i ka propozuar gjykatës që pas administritimit të provave në shqyrtim gjyqësor, të pandehurin t'a shpall fajtor dhe t'a dënojë sipas ligjit.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale sipas aktakuzës së lartshënuar, mbajti shqyrtim fillestar me datë 03.08.2016, në të cilin i pandehuri S.K., i vënë nga gjykata në dijeni të plotë për natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, dhe pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, vullnetarisht pranoi në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, theksoi se ndihet i penduar, i vie keq për rastin e ndodhur, më tej theksoi se ky rast e ka thyer shpirtërisht, me fqinjët e vëllaut thekson se nuk ka pasur asnjë të keqe, janë pajtuar menjëherë me A. Ll. dhe sërish i kërkon falje publikisht, asnjëherë tjetër nuk ka përsëritur vepër të tillë penale dhe në fund premtan se edhe në të ardhmen nuk do të kryejë vepër të tillë penale.

Mbrojtësi i të pandehurit S. K., av. E.Sh. gjithashtu mbështet pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij, pasi që theksoi se është bërë vullnetarisht dhe pa kurrfarë presioni, duke shtuar se në situatën në të cilën është ndodhur i mbrojturi i tij, konsiderohet se është bërë për të parandaluar rrezikun që i kanosej vëllaut të tij. Në fund kërkoi nga gjykata që të ketë parasysh faktin se është familjar, dhe se është penduar sinqerisht për veprën penale të kryer.

Prokurori i shtetit gjithashtu shprehu pajtimin për pranimin e fajsisë nga i pandehuri, meqë pranimi është në përputhshmëri të plotë me provat dhe dëshmitë që ekzistojnë në shkresat e lëndës dhe komfor dispozitave ligjore. Me rastin e matjes së dënimit propozoi që në cilësi të rrethanave veçanërisht lehtësuese përveç pranimit të fajsisë që është bërë në përputhje të plotë me nenin 248 të KPP, si rrethanë lehtësuese të vlerësohet edhe shprehja e keqardhjes së thellë për veprën penale të kryer nga i akuzuari, se është baba i pesë fëmijëve, se është penduar thellë për veprën e kryer penale, se premtion se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera, se me palën e dëmtuar ka arritur pajtimin dhe se i ka kërkuar falje korrekte, ndërkaq si rrethanë rënduese propozoi që të vlerësohet se në momentin kritik i akuzuari e ka keqpërdorur armën zyrtare. Më tej theksoi se duke iu referuar këtyre rrethanave dhe duke shtuar si rrethanë lehtësuese edhe faljen e kërkuar nga i akuzuari, i propozoi gjykatës që të njëjtin t'a shpall fajtor dhe ta dënojë sipas ligjit, duke konsideruar se dënimi i shqiptuar do të jetë në përpjesëtim me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore për vepra të tilla për t'u arritur qëllimi i dënimit.

Pas deklarimit të të pandehurit dhe mbrojtësit të tij për pranimin e fajsisë dhe pas pajtimit të prokurorit për pranimin e fajsisë nga i pandehuri, gjykata gjithashtu e aprovoi pranimin e fajsisë nga i pandehuri, pasi është bindur se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajsisë, dhe se ky pranim është bërë vullnetarisht pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij dhe i mbështetur në faktet e çështjes që përmban aktakuza.

Gjykata, pas aprovimit të fajsisë së të pandehurit dhe vlerësimit të rrethanave të rastit, konstatoi gjendjen e fakteve që e përmbanë akuza, nxjerri konkluzion të drejtë dhe të ligjshëm, se në veprimet e të pandehurit, ekzistojnë elementet e veprës penale që i vihet në barrë, të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, andaj pasi që më parë gjeti se i pandehuri është penalisht përgjegjës, të njëjtin e shpalli fajtor për veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK dhe, i shqiptoi dënimin e paraparë ligjor.

Me rastin e përcakimit të vendimit mbi dënimin ndaj të pandehurit të lartshënuar, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara ligjore që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si, rrethanat lehtësuese: pranimin e fajsisë si rrethanë posaçërisht lehtësuese, pendimin për veprën e kryer dhe premtimin e dhënë në gjykatë se asnjëherë në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla, statusin e tij familjar dhe socialo-ekonomik, ndërsa rrethanë rënduese gjeti faktin e përdorimit të armës jashtë detyrës zyrtare, andaj, ndaj të njëjtit i shqiptoi dënim me gjobë dhe dënim burgimi, të kushtëzuar për periudhën e caktuar verifikuese, të precizuar si në dispozitiv të aktgjykimit, me bindje se dënimi i tillë i përgjigjet peshës së veprës penale, sjelljeve dhe shkallës së përgjegjësisë penale të të pandehurit, se ky dënim do të ndikojë në resocializimin e të njëjtit, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, gjithashtu, do të ndikojë tek të tjerët në mos kryerjen e veprave penale dhe se, me dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPK dhe në fund, me bindje se i pandehuri edhe në të ardhmen nuk do të përsërisë veprën tjetër penale të natyrës së tillë apo të ngjashme.

Vendimin për udhëzimin e të dëmtuarit që kërkesën pasurore juridike t'a realizojë në kontest të rregullt civil, gjykata e mori në bazë të nenit 463 të KPP.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, gjykata e mori në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPP.

Nga sa u tha më lartë, dhe në bazë të nenit 365 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA  
PKR.nr.424/14, me datë 03.08.2016**

**Sekretarja juridike  
Ardita Azemi**

---

**Kryetarja e trupit gjykues,  
Suzana Çerkini**

---

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.